



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

6. 10 2020

18522

UDHËZIM

Nr. 37 datë 6/10/2020

PËR

**MONITORIMIN DHE PUBLIKIMIN PERIODIK TË STOKUT TË DETYRIMEVE  
TË PRAPAMBETURA TË QEVERISJES SË PËRGJITHSHME**

Në zbatim të ligjit Nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare" <sup>(1)</sup>, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 824, datë 19.12.2019, "Për miratimin e strategjisë sektoriale për menaxhimin e financave publike 2019-2022", të Memorandumit të Mirëkuptimit midis Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, si dhe të udhëzimit të ministrit përgjegjës për financat nr. 8 (prot. 5055), datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme",

**U D H Ë Z O J:**

**I-Qëllimi i përgjithshëm**

Monitorimi dhe publikimi i stokut të detyrimeve të prapambetura në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ).

**II-Përkufizime**

Stok i detyrimeve të prapambetura për efekte të këtij udhëzimi konsiderohen detyrimet financiare të transaksioneve të shpenzimeve të njëjësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme (përfshirë edhe njësitë ekstra-buxhetore në varësi të qeverisjes qendrore dhe vendore) të cilat rezultojnë të papaguara prej mbi 60 ditë kalendarike që nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik (lindjes së detyrimit financiar)<sup>1</sup>, si edhe ato pas afatit të pagesës të përcaktuar në marrëveshjen apo legjislacionin përkatës (paga, kontribute të sigurimeve shoqërore dhe

<sup>1</sup> Sipas afatit të përcaktuar në nenin 7, të ligjit 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare". Ky ligj është përfaqësuar me direktivën 2011/7/EU, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 16 shkurt 2011, "Për luftën kundër pagesës me vonesë në transaksionet tregtare".

shëndetsore, tatim mbi të ardhurat personale, rimbursim TVSH-je<sup>2</sup>, vendime gjyqësore, etj.).

### III-Përgjegjësitë e strukturave përfshirëse për raportim dhe publikim

1. Në zbatim të legjislacionit në fuqi **struktura përgjegjëse për financat e njësisë shpenzuese** të qeverisjes së përgjithshme paraqet *menjëherë* në strukturën përgjegjëse për Thesarin në degë detyrimet e prapambetura (për të cilat nuk ka fonde disponibël për të kryer regjistrimin në SIFQ dhe pagesën në afatin e miratuar) nëpërmjet dokumentit “Urdhër regjistrimi i detyrimit të prapambetur” (URDP), formati i të cilit paraqitet në Tabelën 4 në Aneksin 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi. URDP të ketë bashkëlidhur të gjithë dokumentacionin justifikues.
2. **Struktura përgjegjëse për Thesarin në degë**, pas kontrollit të ushtruar në zbatim të legjislacionit në fuqi, regjistron në SIFQ detyrimin e paraqitur nga njësia shpenzuese sipas pikës së mësipërme (një ditar për një URDP) në zbatim të udhëzimit nr. 8 (prot. 5055), datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” (në llogarinë ekonomike 4864-“Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura”, të detajuar në Aneksin 2 të këtij udhëzimi). Kopja përkatëse e URDP arkivohet në degën e Thesarit, duke vendosur në rubrikën përkatëse numrin e ditarit që gjenerohet automatikisht nga SIFQ pas regjistrimit, kurse dokumentacionin justifikues ia kthen njësisë shpenzuese. Çdo muaj, deri në afatin e miratuar për publikimin e të dhënave përfundimtare të treguesve fiskalë të konsoliduar, struktura përgjegjëse për Thesarin në degë kryen rakordimin mujor me njësitë shpenzuese, të konfirmuar zyrtarisht nga nëpunësi autorizues.

Pas regjistrimit të fondeve shtesë në SIFQ nga **strukturat përgjegjëse për buxhetin**, njësitë shpenzuese paraqesin në strukturën përgjegjëse për Thesarin në degë URDP, urdhër shpenzimin, etj. duke vijuar sipas procedurës ekzistuese. Njëkohësisht kryhet edhe stornimi (*ditari me metodën ndërro D/K*) i regjistrimit të mëparshëm në llogarinë ekonomike 4864xxx përkatëse (*me periudhë kontabël që përkon me ditën kur kryhet stornimi*). Për çdo të dhënë të denaturuar të nxirren përgjegjësitë dhe aplikohen masa në zbatim të legjislacionit në fuqi.

3. **Njësitë shpenzuese “online”** me SIFQ nuk i paraqesin detyrimet e prapambetura në strukturën përgjegjëse për Thesarin në degë, por i regjistrojnë direkt në SIFQ sipas përcaktimeve në pikat e mësipërme.
4. **Struktura përgjegjëse për Thesarin në qendër** gjeneron periodikisht nga SIFQ raportet e të dhënave të detajuara të stokut të detyrimeve të prapambetura sipas njësisë shpenzuese të qeverisjes qendrore dhe vendore si dhe sipas natyrës ekonomike të detyrimit të prapambetur (llogaritë ekonomike 4864xxx).

Mbi bazë të këtij informacioni të detajuar gjenerohen të dhënat e agreguara sipas niveleve të qeverisjes së përgjithshme (qendrore dhe vendore) dhe natyrës ekonomike të detyrimeve

---

<sup>2</sup> Afati i rimbursimit të TVSH-së është përcaktuar në nenin 77 të ligjit nr. 92/2014 “Për tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar si edhe në nenin 75/1 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, neni 75/1.

të prapambetura (sipas tabelave në Aneksin 1 të këtij udhëzimi), përveç llogarisë ekonomike 486500 – “Rimbursimi i TVSH-së”. Të dhënat agregohen në një skedar në format “MS Excel”, duke u lidhur me formula me të dhënat e detajuara përkatëse në të njëjtin skedar (në MS Excel). Të dhënat e agreguara të jenë pjesë përbërëse e raportimit mujor të treguesve fiskalë të konsoliduar në version përfundimtar.

Të dhënat e agreguara dhe të detajuara të skedarit në format “MS Excel” si më sipër, i dërgohen me e-mail Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit.

Gjithashtu në korrespondenca mbahen të kopjuar Sekretari i Përgjithshëm i MFE dhe Zëvendësministri që mbulon fushën e shpenzimeve.

5. **Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve** gjeneron periodikisht dhe dërgon (në format “MS Excel”) të dhënat e stokut të detyrimeve të prapambetura nga rimbursimi i TVSH-së, të detajuar sipas Ankesit 1 të këtij udhëzimi dhe ia dërgon me e-mail drejtorive si më poshtë:

- Drejtorisë së Përgjithshme e Politikave Makroekonomike e Fiskale;
- Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dërgon këto të dhëna jo më vonë se 7 ditë pune përpara afatit final për publikim sipas datave përkatëse periodike të përcaktuara më poshtë në pikën 1 të seksionit IV të këtij udhëzimi.

Gjithashtu në korrespondenca mbahen të kopjuar Sekretari i Përgjithshëm i MFE dhe Zëvendësministri që mbulon fushën e të ardhurave tatimore.

6. **Njësia përgjegjëse për monitorimin e risqeve buxhetore** koordinon në vijimësi dhe periodikisht të gjithë procesin që ka për qëllim ky udhëzim. Ajo mbledh të dhënat e detyrimeve të prapambetura të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe përgatit një informacion të konsoliduar tabelor (sipas formatit në Aneksin 1 të këtij udhëzimi) për Ministrin, duke vënë në dijeni edhe Zëvendësministrin që mbulon fushën përkatëse dhe Sekretarin e Përgjithshëm të MFE.

Pas marrjes së konfirmimit/miratimit nga ana e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, njësia përgjegjëse për monitorimin e risqeve buxhetore dërgon për publikim informacionin mbi detyrimet e prapambetura të periudhës përkatëse, sipas formatit të përcaktuar në Aneksin 1 të këtij udhëzimi.

#### **IV-Publikimi i informacionit final, të konsoliduar, në faqen e MFE**

1. Në faqen e MFE do të publikohet në mënyrë periodike si më poshtë, informacioni final dhe i konsoliduar mbi stokun e detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme:

- Brenda datës 1 Shkurt të çdo viti do të publikohet stoku i detyrimeve të prapambetura që i korrespondon fund-periudhës fiskale Janar-Dhjetor të vitit paraardhës në version paraprak dhe brenda muajit Maj në version përfundimtar.
- Brenda datës 30 Prill të çdo viti do të publikohet stoku i detyrimeve të prapambetura që i korrespondon fund-periudhës fiskale Janar – Mars të po atij viti.
- Brenda datës 31 Korrik të çdo viti do të publikohet stoku i detyrimeve të prapambetura

që i korrespondon fund-periudhës fiskale Janar – Qershor të po atij viti.

- Brenda datës 30 Tetor të çdo viti do të publikohet stoku i detyrimeve të prapambetura që i korrespondon fund-periudhës fiskale Janar – Shtator të po atij viti.
- 2. Afatet e mësipërme janë në varësi të publikimit në version final të treguesve fiskalë të konsoliduar periodikë dhe vjetor në zbatim të urdhrimit të ministrit përgjegjës për financat nr. 100 (prot. 17029), datë 10.12.2014 “Mbi afatet e rakordimit, raportimit dhe publikimit të treguesve fiskalë të konsoliduar të qeverisë”, i cili miraton rregulloren e brendshme për zbatim nga strukturat përgjegjëse gjithëpërfshirëse.
- 3. Formati i publikimit paraqitet në Ankesin 1 të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim zbatohet nga të gjitha njësitë e përfshira.

**MINISTRI I FINANCËVE DHE EKONOMISË**

**ANILA DENAJ**



ANEKSI I

Tabela 1: Stoku i detyrimeve të prapambetura të qeverisë së përgjithshme (seri kohore sipas llogarive ekonomike kryesore)

| (million Lekë)  | Në fund-vitin 2018 | Në fund-vitin 2019 | Deri në fund-Mars 2020 | Deri në fund-Qershor 2020 | Deri në fund-Shtator 2020 | Në fund-vitin 2020 | Deri në fund-Mars 2021 | ...   |
|---|--------------------|--------------------|------------------------|---------------------------|---------------------------|--------------------|------------------------|-------|
| Stoku Total i detyrimeve të prapambetura të Qeverisë së Përgjithshme (I + II) | XXXXX              | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX                     | XXXXX                     | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX |
| I) nga Qeveria Qendrore (përfshirë të gjitha institucionet buxhetore) (1 + 2) | XXXXX              | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX                     | XXXXX                     | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX |
| 1.) nga kontratat dhe detyrime të tjera të Qeverisë Qendrore                  | XXXXX              | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX                     | XXXXX                     | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX |
| 1.a) Vendime Gjyqesore  | XXXXX              | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX                     | XXXXX                     | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX |
| 1.b) Shërbime   | XXXXX              | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX                     | XXXXX                     | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX |
| 1.c) Mirëmbajtje  | XXXXX              | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX                     | XXXXX                     | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX |
| 1.d) Investime  | XXXXX              | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX                     | XXXXX                     | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX |
| 1.e) Të tjera, nga të cilat:  | XXXXX              | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX                     | XXXXX                     | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX |
| Sigurime Shoqërore  | XXXXX              | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX                     | XXXXX                     | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX |
| Sigurime Shëndetësore   | XXXXX              | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX                     | XXXXX                     | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX |
| Të Ardhura Personale  | XXXXX              | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX                     | XXXXX                     | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX |
| Tatime të tjera   | XXXXX              | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX                     | XXXXX                     | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX |
| 2.) nga Rimbursimi i TVSH   | XXXXX              | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX                     | XXXXX                     | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX |
| 2.a) për projektet e mëdha / specifike  | XXXXX              | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX                     | XXXXX                     | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX |
| 2.b) për të gjitha të tjerat  | XXXXX              | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX                     | XXXXX                     | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX |
| II) nga Qeveria Vendore   | XXXXX              | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX                     | XXXXX                     | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX |
| 1.) nga kontratat dhe detyrime të tjera të Qeverisë Vendore                   | XXXXX              | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX                     | XXXXX                     | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX |
| 1.a) Vendime Gjyqesore  | XXXXX              | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX                     | XXXXX                     | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX |
| 1.b) Shërbime   | XXXXX              | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX                     | XXXXX                     | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX |
| 1.c) Mirëmbajtje  | XXXXX              | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX                     | XXXXX                     | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX |
| 1.d) Investime  | XXXXX              | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX                     | XXXXX                     | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX |
| 1.e) Të tjera, nga të cilat:  | XXXXX              | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX                     | XXXXX                     | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX |
| Sigurime Shoqërore  | XXXXX              | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX                     | XXXXX                     | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX |
| Sigurime Shëndetësore   | XXXXX              | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX                     | XXXXX                     | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX |
| Të Ardhura Personale  | XXXXX              | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX                     | XXXXX                     | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX |
| Tatime të tjera   | XXXXX              | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX                     | XXXXX                     | XXXXX              | XXXXX                  | XXXXX |

Shënim: Të gjitha të dhënat, përveç rimbursimit të TVSH, janë të dhëna të gjeneruara nga Sistemi i Thesarit (SIFQ). Të dhënat për rimbursimin e TVSH janë gjeneruar dhe raportuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Tabela 2: Stoku i detyrimeve të prapambetura deri në fund-(muaji xxx) (viti xxx) për cdo institucion sipas llogarive ekonomike kryesore

| Nr.                                      | në milion Lekë       |      | a) Vendime Gjyqësore | b) Shërbime | c) Mirëmbajtje | d) Investime | e) Të tjera | nga Rimbursimi i TVSH | Total |
|--|----------------------|------|----------------------|-------------|----------------|--------------|-------------|-----------------------|-------|
|  | Emri i Institucionit |      |                      |             |                |              |             |                       |       |
| 1  | Institucioni         | XXXX | XXXXX                |             |                |              |             |                       | XXXXX |
| 2  | ...                  |      | XXXXX                |             |                |              |             |                       | XXXXX |
| 3  | ...                  |      | XXXXX                |             |                |              |             |                       | XXXXX |
| 4  | ...                  |      | XXXXX                |             |                |              |             |                       | XXXXX |
| 5  | ...                  |      | XXXXX                |             |                |              |             |                       | XXXXX |
| <b>Totali i Qeverisë Qendrore</b>        |                      |      | XXXXX                |             |                |              |             |                       | XXXXX |
| 6  | Bashkia              | XXXX | XXXXX                |             |                |              |             |                       | XXXXX |
| 7  | ...                  |      | XXXXX                |             |                |              |             |                       | XXXXX |
| 8  | ...                  |      | XXXXX                |             |                |              |             |                       | XXXXX |
| 9  | ...                  |      | XXXXX                |             |                |              |             |                       | XXXXX |
| 10                                       | ...                  |      | XXXXX                |             |                |              |             |                       | XXXXX |
| <b>Totali i Qeverisë Vendore</b>         |                      |      | XXXXX                |             |                |              |             |                       | XXXXX |
| <b>Totali i Qeverisë së Përgjithshme</b> |                      |      | XXXXX                |             |                |              |             |                       | XXXXX |

Shënim: Të gjitha të dhënat, përvec rimbursimit të TVSH, janë të dhëna të gjeneruara nga Sistemi i Thesarit (SIFQ). Të dhënat për rimbursimin e TVSH janë gjeneruar dhe raportuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

**Shënim metodologjik:** Llogarive ekonomike në Tabelat 1 dhe 2 u korrespondojnë kodet nga sistemi i thesarit (SIFQ) përkatësisht sipas kolonës së parë në Tabelën 3 më poshtë:

**Tabela 3: Kodet e llogarive ekonomike në sistemin e thesarit (SIFQ)**

| <b>Llogaria ekonomike</b> | <b>Përshkrimi</b>     |
|---------------------------|-----------------------|
| 4864100                   | Vendime Gjyqësore     |
| 4864200                   | Shërbime              |
| 4864300                   | Mirëmbajtje           |
| 4864400                   | Investime             |
| 4864500                   | Rimbursimi i TVSH     |
| 4864600                   | Mallra                |
| 4864601                   | Sigurime Shoqërore    |
| 4864602                   | Sigurime Shëndetësore |
| 4864603                   | Të Ardhura Personale  |
| 4864604                   | Tatime te Tjera       |
| 4864900                   | Të tjera              |

ANEKSI 2

Tabela 4: Formati i urdhër regjistrimit të detyrimit të prapambetur

|                                 |                                     |  |  |
|---------------------------------|-------------------------------------|--|--|
| <b>Emërtimi i Institucionit</b> | Ministria e Financave dhe Ekonomisë |  |  |
| <b>NIPT-i</b>                   | K02231002H                          |  |  |
| <b>Kodi i Institucionit</b>     | 1010001                             |  |  |
| <b>Entiteti qeverisjes</b>      | 001                                 |  |  |
| <b>Distrikti (TDO)</b>          | 3535                                |  |  |
| <b>Kategoria</b>                | GoA Detyrim i Prapambetur           |  |  |
| <b>Numri i ditarit në SIFQ</b>  |                                     |  |  |

**URDHËR - REGJISTRIMI  
DETYRIM I PRAPAMBETUR**

NR. \_\_\_\_\_, DATË \_\_/\_\_/\_\_\_\_

*Në lekë*

| Nr. | Struktura e llogarisë |                    | SHUMA             | Përshkrimi   |
|-----|-----------------------|--------------------|-------------------|--|
|     | Ministria             | Llogaria Ekonomike |                   |  |
| 1   | 10                    | 4864400            | 10,000.00         | Projekti 18AY603-Ndërtim i shkollës profesionale të IT |
|     |                       |                    |                   |  |
|     |                       | <b>Totali</b>      | <b>10,000.00</b>  |  |
|     |                       | (me fjalë)         | (Dhjetëmijë lekë) |  |

|   |  |
|---|--|
| <b>Të dhëna për kreditorin përfitues:</b> | <b>Dokumentat justifikues të shpenzimit:</b> |
| Emri i përfituesit                        | 1.   |
|   | 2.   |
| NIPT-i:                                   | 3.   |
| IBAN:                                     | 4.   |
| Nr.llog.bankare:                          | 5.   |
| Emri i Bankës                             |  |
| Adresa e Bankës:                          |  |

|                            |                         |                             |  |
|----------------------------|-------------------------|-----------------------------|--|
| <b>PËR INSTITUCIONIN</b>   |                         | <b>PËR DEGËN E THESARIT</b> |  |
| <b>NËPUNËSI AUTORIZUES</b> | <b>NËPUNËSI ZBATUES</b> | Aprovuar datë: _____        |  |
| (Emër, Mbiemër, Firmë)     | (Emër, Mbiemër, Firmë)  | <b>NËPUNËSI I THESARIT</b>  |  |
| <b>Vula</b>                |                         | (Emër, Mbiemër, Firmë)      |  |
|                            |                         | <b>Vula</b>                 |  |

**Shënim:** Qelizat "Nr. i Ditarit në SIFQ"(Sistemi Informatik Financiar i Qeverise) dhe "Aprovuar datë" plotësohen nga nëpunësi i degës së Thesarit.



**Shënim metodologjik:** Mbrapa faqes së formatit të Urdhër Regjistrimit të Detyrimit të Prapambetur vendosen llogaritë ekonomike analitike si më poshtë.

Llogaritë ekonomike janë sipas udhëzimit nr. 8 (Prot. 5055), datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*".

| <b>Llogaria ekonomike</b> | <b>Përshkrimi</b>     |
|---------------------------|-----------------------|
| 4864100                   | Vendime Gjyqësore     |
| 4864200                   | Shërbime              |
| 4864300                   | Mirëmbajtje           |
| 4864400                   | Investime             |
| 4864500                   | Rimbursimi i TVSH     |
| 4864600                   | Mallra                |
| 4864601                   | Sigurime Shoqërore    |
| 4864602                   | Sigurime Shëndetësore |
| 4864603                   | Të Ardhura Personale  |
| 4864604                   | Tatime te Tjera       |
| 4864900                   | Të tjera              |